VENDIM
Nr.562, datë 22.8.2007

PËR SHKËPUTJEN E INSTITUTIT TË KËRKIMEVE BIOLOGJIKE NGA AKADEMIA E SHKENCAVE DHE INTEGRIMIN E TIJ NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike (IKB) nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij, si pjesë përbërëse, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN), të Universitetit të Tiranës (UT), i cili do të organizohet, si më poshtë vijon:

a) Departamenti i Bioteknologjisë;

b) Seksioni i Florës, i Muzeut të Shkencave të Natyrës.

2. Misioni i njësive të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, përfshin:

a) formimin universitar të studentëve dhe shkencëtarëve;

b) kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;

c) shërbimet për të tretë, si dhe transferimin e njohurive e të teknologjisë, në fushat e bioteknologjisë, biologjisë molekulare dhe biodiversitetit.

3. Njësitë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, organizohen dhe funksionojnë sipas dispozitave të Ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Detyrat dhe funksionimi i tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit.

4. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007", shtohen 25 veta për FSHN-në, e UT-së, të cilët pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator- 31 dhjetor për Akademinë e Shkencave, së bashku me fondet buxhetore për paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 8 680 000 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

5. Struktura dhe organika e njësive të reja, që krijohen, të përmenduara në pikën 1 të këtij vendimi, përgatiten në bazë të numrit të përgjithshëm të punonjësve, miratuar në pikën 4 të këtij vendimi, dhe miratohen nga rektori i UT-së.

6. Pasuritë, e luajtshme dhe të paluajtshme (burime financiare, mjedise pune, laboratorë, zyra, automjete, donacione, projekte kërkimi dhe zhvillimi, orendi, infrastrukturë informatike, etj., si dhe arkivat shkencorë e çdo dokumentacion tjetër arkivor) të ish-IKB-së, kalojnë në pronësi të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës.

7. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin një urdhër të përbashkët, për inventarizimin dhe transferimin e aseteve të pasurive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha